




**PROGRAM ORIENTUES
PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR
“MËSUES PËR SHQIPËRINË”
2025**

**PËR
SHKOLLAT ME DREJTIM
TË ORIENTUAR ARTISTIK**

DEGËT: ART FIGURATIV, KOREOGRAFI, MUZIKË





TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE	4
FUSHA: PROGRAMET LËNDORE.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE- NXËNIE.....	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	9
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS	11



HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë”, degët: *Art figurativ, koreografi, muzikë*, është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në këto degë. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve.
- b) Kurrikulat e degëve artistike përkatëse, miratuar nga MAS, 2016.
- c) Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë në mësimdhënie-nxënie.
- d) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- e) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- f) Përmbajtja shkencore sipas kurrikulave të degëve artistike përkatëse.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë, duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë”, degët: *art figurativ, koreografi, muzikë*, është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të shkollave me drejtim të orientuar artistik në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor;
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për zhvillimin e aftësive/kompetencave artistike, teorike dhe praktike (artistike – profesionale), si dhe për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes;
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të shkollave me drejtim të orientuar artistik, është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave artistike - profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i këtyre degëve, përkatësisht: *art figurativ, koreografi, muzikë*.

Përshkallëzimi i njohurive, i aftësive profesionale dhe artistike, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** në funksion të tyre që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

Kompetenca “Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar, si dhe dispozitat normative të këtij sistemi; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe	- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. - Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”. - Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për

rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; - zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; - demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; - zbaton etikën profesionale të mësuesit; - respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; - respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; - zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.	numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar. - Udhëzimi nr. 17, datë 22.07.2024. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të punonjësve arsimorë”. -Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”. -Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. - Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.
---	--

FUSHA: PROGRAMET LËNDORE

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i kurrikulës (art figurativ, koreografi, muzikë) në shkollë”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - njeh plotësisht kurrikulën e degës përkatëse, dhe të gjitha rubrikat që ajo ka; - zbaton programin e lëndës duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë individuale artistike të nxënësit; - përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; - përdor me efikasitet, në dobi të zhvillimeve artistike bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit lëndor praktik - profesional; - gjen ose zhvillon materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e njohurive, aftësive/kompetencave artistike të parashikuara në program; - gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin artistik profesional të nxënësve, duke nxitur mendimin e pavarur dhe kritik të tyre ndaj veprave artistike;	- Korniza Kurrikulare, 2014. - Kurrikulat e degëve artistike, <i>art figurativ, koreografi, muzikë</i>, miratuar nga MASH, 2010. - Kurrikulat e degëve artistike, <i>art figurativ, koreografi, muzikë</i>, miratuar nga MAS-i 2016.

- harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, në përputhje me kompetencat artistike që duhet të realizojë programi; - tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve lëndore sipas specialiteve); - përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e kompetencave artistike sipas fushës/specialitetit që mbulon.	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

Kompetenca I	
“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e arteve”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; - përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve në specialitetin e vet; - demonstroi respekt, besim dhe objektivitet ndaj nxënësve; - planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë	- Kurrikulat e degëve artistike, <i>art figurativ, koreografi, muzikë</i>, miratuar nga MASH, 2010. - Kurrikulat e degëve artistike, <i>art figurativ, koreografi, muzikë</i>, miratuar nga MAS, 2016. - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Literaturë nga interneti që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.

me nxënësit sipas aftësive artistike që ata kanë; - edukon te nxënësit dashurinë për profesionin që ata kanë zgjedhur të formohen; - motivon nxënësit vazhdimisht duke e konsideruar motivimin si një nga çelësat e progresit të tyre; - krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe pozitive për nxënësit; - punon me prindërit dhe kolegët për përmirësimin e progresit dhe ecurisë të nxënësit.	
Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e arteve”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - përzgjedh rrugën apo metodat për zhvillimin e programit mësimor në një periudhë të caktuar (mujore/tremujore); - përdor metoda apo teknika të caktuara (në varësi të fushës/specialitetit) që zhvillojnë aftësitë interpretative apo kompetencat artistike në zhvillimin e produkteve (detyrë apo repertor); - përdor demonstrimin si pjesë e procesit artistik në mësimdhënie;	- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. - Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019. - Kurrikulat e degëve artistike, <i>art figurativ, koreografi, muzikë</i>, 2016. - Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. - Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies dhe metodologjinë e mësimdhënies së arteve. - Udhëzues dhe materiale mbështetëse që

- shpjegon kriteret e vlerësimit të nxënësit në varësi të ecurisë përgjatë gjithë muajve dhe vitit shkollor (në kontroll teknik/saxho/detyra apo produkte të realizuara).	orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësimi, për përgatitjen e planit ditor të mësuesit, për organizimin e orës së mësimi. -
Kompetenca III “Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies e arteve”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - prezanton materiale artistike në lidhje me fushën/specialitetin e vet duke nxitur diskutimin, përmes përdorimit të teknologjisë bashkëkohore në funksion të artit që studion; - nxit nxënësit të zhvillojnë ndjenjën e kërkimit dhe krahasimit të veprave muzikore, koreografike apo të artit, duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta; - gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
-------------------	---------------------------------

“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - njeh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve: (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - njeh rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; - demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.	- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca “Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e arteve”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i arteve (art figurativ, koreografi, muzikë):</i> - zhvillon tek nxënësit aftësitë/kompetencat artistike, shprehinë kryesore me të cilat operon lënda/specialiteti i tij; - zhvillon në mënyrë të qartë për secilin nxënëës ose për grup nxënësish (varet nga dega artistike) metodologjinë e formimit të njohurive dhe të aftësive artistike sipas programit, talentit dhe grupmoshave; - njeh dhe zhvillon në mënyrë të qartë programin mësimor në aspektin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të zhvillimit të aftësive artistike (sipas degës/specialitetit); - përdor demonstrimin apo forma të tjera pune, për të zhvilluar natyrshëm njohuritë dhe aftësitë artistike, bazuar në kërkesat e programit, talentit dhe grupmoshave (sipas degës/specialitetit); - zhvillon kompetenca të përgjithshme dhe specifike artistike profesionale, bazuar në misionin që ka shkolla për këtë grup nxënësish.	- Programe dhe tekste të lëndës për mësuesin dhe nxënësin. - Materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës/specialitetit.

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al